



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës  
Skupština Opština  
Municipal Assambly

Kryetari i Komunës  
01.Nr. 670/01-8734/17  
Kaçanik, 20.03.2017

Në mbështetje të Vendimit të Kuvendit të Komunës 01.Nr. 400-2155/17 të datës 27.01.2017, Vendimit të Kryetarit të Komunës 01.Nr.670/-01-8734/17 si dhe Rregullores Nr.06/2016 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Komuna e Kaçanikut, bënë:

### KONKURS PËR NDARJEN E BURSIVE PËR VITIN AKADEMIK 2016-2017

1 .Komuna e Kaçanikut, për vitin akademik 2016 -2017, do të ndan 50 bursa me nga 40 € në muaj (për 10 muaj) për student të rregullt të studimeve themelore.

Për të aplikuar për bursë, studentët duhen t'i plotësojnë këto kushte:

- 1.1 të jenë banorë të Komunës së Kaçanikut,
- 1.2 të jenë student të rregullt të Universiteteve Publike,
- 1.3 të kenë dhënë të gjitha provimet e vitit paraprak,
- 1.4 të jenë student të vitit të dytë e më lartë,
- 1.5 të mos jenë përsëritës të vitit,
- 1.6 të kenë notën mesatare 7,50 e më lartë, përveç studentëve të profileve deficitare (Fakulteti i Mjekësisë së Përgjithshme, Fakulteti Teknik-Drejtimi Elektro, Arkitekturë dhe Ndërtimtari, FSHMN-Drejtimi Matematikë dhe Fizikë profili arsimor),
- 1.7 të mos jenë përfitues të bursës brenda vitit të njëjtë nga ndonjë burim tjetër, dhe
- 1.8 prej një familje mund të jetë përfitues i bursës vetëm një student.

2. Studentët të cilët i plotësojnë kushtet nga pika (I) e këtij konkursi duhet t'i paraqesin këto dokumente:

- 2.1 çertifikata e provimeve të dhëna origjinal dhe kopjen e indeksit,
- 2.2 deklarata e bashkësisë familjare,
- 2.3 ekstraktin e lindjes,
- 2.4 dëshmia e regjistrimit të vitit akademik 2016-17,
- 2.5 dëshmi se është fëmijë: i invalidit të luftës, fëmijë i dëshmorit, i veteranit të luftës, i martirit të luftës, person me aftësi të kufizuara, është nga familja në skemën sociale dhe se janë dy e më tepër student të një familje.

#### Afati dhe mënyra e aplikimit.

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve bëhet në objektin e Komunës së Kaçanikut, Zyra e Pritjes (sporteli nr. 5 nga ora 08:00-16:00 çdo ditë pune).

Afati për aplikim është 15 ditë pune, nga dita e shpalljes së këtij konkursi.



Kryetari i Komunës;  
Besim Ilazi